



Planuar / Diturazat Planned / Pradato Received / Delivary	22-09-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojç / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	5603/2022		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.780/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.780/2022 të datës 08.09.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Komuna e Prizrenit, kundër organit të punësimit Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.09.2022, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *Shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.780/2022 të datës 08.09.2022 të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi kandidat në Konkursin me numër reference RN00009166 dhe RN00009167 të datës 03.06.2022, për pozitën e punës Drejtor/Zëvendësdrejtor i Shkollës SHMPL "Ymer Prizreni" në Prizren, me datë 08.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5215/22 të regjistruar nën shenjen A.nr.780/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 06/030-129848 të datës 23.08.2022 të Komisionit të Ankesave në kuadër të Kuvendit Komunal të Prizrenit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.09.2022 përmes emailit ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Prizrenit. Këshilli, me datë 13.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5215/2022 të datës 08/09/2022 të parashtruar nga ankuesi përmes postës së





Kosovës me datën 06.09.2022; Njoftimin me Nr.2627/2022 të datës 04.08.2022; Shkresën e datës 02.09.2022; Vendimin me numër 06-030-129848 të datës 23.08.2022 të Komisionit të Ankesave; Emalin e datës 13.09.2022 të drejtuar Këshillit; Emalin e datës 12.09.2022 të drejtuar Emalin e datës 12.09.2022 të drejtuar Emalin e datës 12.09.2022 të Këshillit drejtuar I. Gashi; Konkursin e datës 03.06.2022; Listën e kandidatëve që kanë konkurruar në pozitën drejtor në Shkollën "Ymer Prizreni"; Listën e datës 13.07.2022 lidhur me kandidatet që kanë hyrë në listën e ngushte; Formularin "F" të datës 20.07.2022 të vëzhguesit Formularin "F" të datës 20.07.2022 të vëzhguesit Formularin "F" të datës 20.07.2022 të vëzhguesit Rangimin e datës 20.07.2022 i kandidatëve të vlerësuar nga komisioni përzgjedhës për pozitën Drejtor; Formulari "E" rekomandimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit /eshes dhe zëvendësdrejtorit /eshes të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues të datës 20.07.2022; Listën me numër 2458 të datës 14.07.2022 lidhur me orarin e intervistës së kandidatëve për drejtor dhe zëvendësdrejtor të shkollave sipas konkursit RN00009166 dhe RN00009167 të datës 03.06.2022; Njoftimin me Nr.2627/2022 të datës 04.08.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë administrimit të provave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën A.nr.780/2022 të datës 08.08.2022 të parashtruar nga ankuesi

#### **SEPSE:**

Nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi ka aplikuar në Konkursin e datës 03.06.2022 të shpallur nga Komuna e Prizrenit për pozitën e punës "Drejtor në SHMLP "Ymer Prizreni" në Komunën e Prizrenit. I pakënaqur me rezultatin përfundimtar, i njëjti me datën 17.08.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publikë dhe Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës pranë Komunën e Prizrenit. Ky i fundit me Vendimin me Nr.06-030-129848 të datës 23.08.2022 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.06-030-1295848 të datës 23.08.2022 të Komisionit të Ankesave, me datën 08.09.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me kërkesë për anulimin e Vendimit me Nr.06-030-1295848 të datës 23.08.2022 të Komisionit të Ankesave dhe rrjedhimisht procedurës së rekrutimit për pozitën e punës "Drejtor në SHMLP "Ymer Prizreni" në Komunën e Prizrenit.

Kolegji i Këshillit lidhur me kompetencën lëndore të Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 2 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3 *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë, dhe paragrafin 4 të të njëjtit nen ku përcaktohet se: 4. **Nëpunës i Shërbimit Publik** - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së pozita Drejtor i Shkollës nuk hyn në kategorinë e pozitave në kuadër të Shërbimit Civil.*





Në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit zyrtarët publikë të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të institucioneve publike të arsimit në Kosovë kanë statusin e Nëpunësit të Shërbimit Publikë, siç përcaktohet me nenin 4 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet që Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, dhe duke marr parasysh se ankuesi ka aplikuar për një pozite e cila nuk hynë në kuadër të pozitave të punës në Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.780/2022 të datës 08.09.2022 të parashtruar nga ankuesi

Bazuar në dispozitat e nenit 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe duke marr parasysh se ankuesi ka shfrytëzuar mjetet ankimore brenda institucionit, Kolegji i Këshillit e udhëzon palën ankuese për inicimin e kontestit të punës në gjykatën kompetente.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.780/2022

**Ilire Mehmeti-Shaqiri**

*Procesmbajtëse*

**Jeton Koca**

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

